



REPUBLIKA E SHqipërisë  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Nr. 1479 prot

Tiranë, më 20.04.2023

**Njoftim: LISTA E APLIKIMEVE TË KUALIFIKUARA PËR SKEMËN  
KOMBËTARE 2023 MASAT 1 6 dhe 9.**

Bazuar në VKM me nr. 125, datë 1.3.2023 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2023” pika 3, AZHBR shpall listat e aplikimeve të masave 1 - 4 të pranuar Online nga portali e-Albania sipas afatit të përcaktuar në Udhëzimin e përbashkët me Nr. 5, të MBZHR dhe MFE “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” me të dhëna si më poshtë:

MASA 1: “Për tufën bazë të matrikulluar të krerëve të gjedhit” janë kualifikuara 3422 aplikime.

MASA 2: “Për tufën bazë të matrikulluar të krerëve e të imtave” janë kualifikuara 5196 aplikime.

MASA 3: “Për mbarështimin e bletarisë” janë kualifikuara 3899 aplikime.

MASA 4: “Mbështetje për fara/fidanë dhe inpute të tjera” janë kualifikuara 908 aplikime.

MASA 5: “Mbështetje për Fermat organike për periudhën në kalim” janë kualifikuara 346 aplikime.

MASA 6: “Mbështetje për Fermat me certifikimin Global GAP”, janë kualifikuara 102 aplikime.

MASA 9: “Mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi” do t’i nënshtrohen fillimisht shqyrtimit administrativ 33398 aplikime

Të gjitha aplikimet sipas subjekteve/aplikantëve që gjenden sipas listave të aplikimeve të kualifikuara për masën 1-6 dhe për rastet që kërkohet dokument sipas masës përkatëse dhe që kanë nevojë për dokumente shtesë sipas tabelave të më mëposhtme, duhet t’i dorëzojnë këto dokumente të plota brenda datës 08.05.2023.

Plotësimi i dokumenteve përtej kësaj date do të rezultojë në skualifikim të aplikimit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Oltjon Muzaka

